REVISTË SHKOLLORE E M.M. "ALAUDDIN" PRISHTINË
nr. 31 • Maj 2011

DRITA e KUR'ANIT

نور القرآن

MADHËSHTIA e PIRAMIDAVE

A E PËRKRAH ISLAMI TERRORIZMIN!?

KISHIM, KEMI DHE DO TË KEMI NEVOJË PËR TY

SI MUND T'JU THEM LAMTUMIRË?!

ANALIZË E KOHËS SË MËSIMIT

Medreseja e Mesme "Alauddin" - Prishtinë

Gjenerata 44

Viti 2007/2011

Takimi në vitin 2021

Designed by Nol Albaraci



Përmbajtja:

3 - Përmbajtja, redaksia
4/5 - A e përkrah Islami terrorizmin
6 - Kishim, kemi dhe do të kemi nevojë për ty.
7/8 - Madhështia e piramidave
9 - Poezi
10/11 - Kuizi i diturisë / nxënësit e dalluar
12 - Ese
13 - Vizitat në Medrese
14 - Zbulimet e reja
15 - Format relievore
16 - Ese
17 - Buzëqesh
18/19 - Fjalët e maturantëve
20 - Si mund t'ju them lamtumirë
21 - Do ndjej mall për ju
22 - Ese, poezi
23 - Suksese në arerën ndërkombëtare
24/27 - Përkthime nga gj. arabe
28 - Aktivitete shkollore
29 - Këshilla dhe fjalë të urta
30 -Aktivitete jashtëshkollore
31 - Kuriozitete dhe barsoleta
32 - Analizë e kohës së mësimit
33 - Fjalëkryqi
34 - Trekëndëshi magjik

FJALA E KRYEREDAKTORES

Falënderimet e pakufishme i takojnë vetëm Allahut të Madhëruar, i Cili gjënë e parë që e krijoi ishte penda. Kjo na bëri të kuptojmë se dhuntitë që na dhuroi Zoti janë më të sigurta nëse ato shkruhen.

Ky dhe shkaqe tjera ndikuan që pos obligimeve të shumta, mbi supet tona të marrim edhe "Dritën e Kur'anit". Pas një pune mjaft të vështirë, arritëm që edhe këtë sfidë ta finalizojmë me kurorën e suksesit.

Falënderoj përzemërsisht të gjithë nxënësit e shkollës, sidomos grupin e redaksisë dhe kujdestarët e klasave të trembëdhjeta për ndihmën dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme. Njëkohësisht falënderoj drejtorin e shkollës, z.Bahri ef. Simnica për përkrahjen e dhënë që edhe ky numër i revistës sonë të jetë në duart tuaja.

"Zoti nuk e ndryshon gjendjen e një populli përderisa ata ta ndryshojnë veten e tyre."

Ndryshimi i gjendjes së Ummetit dhe rimëkëmbja e tij është obligim edhe yni sepse ne jemi ardhmëria e tij.

Atëherë nëse nuk punoj unë, nëse nuk punon ti, nëse nuk punojmë ne, si do të arrijmë ta shndërrojmë errësirën në dritë?!

Kryeredaktore:
Adelina Tahiri

Redaktor:
Gëzim Ilazi

Antarët tjerë:
Hikmete Zymberi, Qëndrim Ferizi, Nexhmi Syla, Albulena Hajraj, Ensar Halimi, Xhevdet Rizahu, Fanol Kashtanjeva, Merjeme Kqiku, Vesel Sylejmani, Mërgim Hasani , Eliza Bublaku .

Redaktore gjuhësore:
Shahë Memishi
Dizajn:
Bashkim Mehani

E-mail : *redaksia_v@ hotmail.com*
redaksia_d@hotmail.com
www.medreseja.com

A E PËRKRAH ISLAMI TERRORIZMIN!?

„Revanshizmat, mëritë dhe hasmëritë, i vetmi ilaç i të cilave është toleranca."
Arnold Volltrei

Si duhet të kuptohet ISLAMI

Plan programi mësimor na mëson që feja islame dhe bindja në të ka dy burime hyjnore që burojnë prej Zotit xh.sh. dhe që janë të shpalosura në Librin e Tij Famëlartë - Kur'anin, që është i pa të metë e aktual për të gjitha kohërat, dhe në trashëgiminë fetare të Dërguarit të fundit Muhamedit s.a.v.s., i cili asnjëherë nuk foli apo veproi pa miratimin e Zotit Mëshirëplotë.

Nga këto mësime bazike fetare kuptojmë se Islami është krejtësisht ndryshe nga ajo që i vishet dhe se Islami është i harmonizuar me jetën, tolerancën dhe paqen e jo me vdekjen, tmerrin dhe kaosin.

Islami është besim, bindje dhe model i jetës i përmbledhur në 33 konditat (shartet) e tija, të cilat janë Kushtetutë për besimtarin dhe doracak për tu kuptuar besimi islam. Ja si definohen termat Iman dhe Islam në akaidin islam: Kur përmendim termat IMAN dhe ISLAM, duhet pasur parasysh se këto dy fjalë, bazuar në domethënien e tyre, përfshijnë tërë fenë islame. Rreth domethënies së këtyre dy fjalëve janë dhënë mendime të shumta. Para se t'i përmendim disa nga ato mendime, do të shërbehemi me fjalët e Muhamedit a.s. se çka thotë lidhur me imanin: Meleku, që ishte paraqitur në formë njeriu, në praninë e shokëve të tij, kur e pyct Muhamedin a.s. se çka është Imani, Muhamedi a.s. iu përgjigj:

"Imani është besimi në Zotin Një, në engjëjt e Tij, në librat e shenjta, në Pejgamberët, në Ditën e Fundit dhe gjithçka që ndodh, qoftë mirë ose keq, është në dijen dhe vullnetin e Allahut xh.sh.". Transmetojnë: Buhariu dhe Muslimi.

Ndërsa: *"Islami është dorëzim dhe nënshtrim ndaj tërë asaj me të cilën është dërguar Pejgamberi a.s. vërtetësia e të cilës është e padiskutueshme."*

Çka është terrorizmi?

Kuptimin gjuhësor të fjalës terrorizëm më së miri mund ta kuptojmë nga fjalori anglisht i Oxfordit "The Oxford English Dictionary", i cili jep një detaj shumë interesantë për terrorizmin. Teror (lat. terror-terrorem, fol. terrere, të frigosh), do të thotë: (1) gjendje frike, tmerri, frik intensive, (2) vepër apo cilësi e cila fut frikën. Pra, terrorizmi është sistem i frikës apo sundim i frikës.

Mirëpo, sipas analistëve të botës islame, termi terrorizëm, për myslimanët ka filluar të adresohet sikurse të ishte mbiemri i emrit mysliman, menjëherë pas sulmeve në kullat binjake në New York të 11 shtatorit 2001, dhe aty për aty me të madhe dhe pa përjashtim.

Mirëpo, Organizata e Konferencës Islame në disa konferenca të saja në vazhdimësi që nga viti 1969, pra, që nga djegia barbare e xhamisë së tretë të shenjtë të Aksas në Jerusalem ka nxjerrë konventa që e gjykojnë dhe e luftojnë terrorizmin si dukuri dhe si formë e mendimit dhe të realizimit të qëllimeve politike apo të ndonjë natyre tjetër.

Por menjëherë pas shtatorit 2001 një institucion që ka reputacion mbar islam siç është Akademia për kërkime islame pran Al-Azharit është paraqitur me deklaratën e qëndrimit islam ndaj fenomenit të terrorizmit.

Për arsye të caktuara dëshiroj t'i theksoj tri parime bazë të kësaj deklarate: e para, islami shikon në shumë zakonshmëri fetare, të bashkësive konfesionale, popujve, kulturave dhe civilizimeve si një rend i Zotit. E dyta bashkëjetesa e nacionaliteteve dhe popujve në përparimin njerëzor të lidhura me sundimin e sistemit të vlerave dhe moralit të bazuar në fe, në radhë të parë në vlerat e drejtësisë, respektimin e parimeve ndërkombëtare të drejtësisë, respektimin e principeve ndërkombëtare të drejtësisë dhe autoritetin e institucioneve ndërkombëtare. Dhe e treta është e domosdoshme të kufizohen në mendime, kulturë dhe informim kuptimi i qëllimshëm i termit, i cili shumë shpesh po shfrytëzohet në këtë kampanjë të tmerrshme kundër *Islamit* dhe *myslimanëve*.

Islami me vlerat e veta gjithmonë ka dhënë dhe do të jep alternativ më të mirë për çdo pyetje që i kërkohet përgjigja korrekte. Prandaj, bota islame ka institucione të respektuara dhe shumë kompetente për komentimin e dukurive dhe kuptimeve të teksteve të saja fetare. Me këtë kontribut modest ftoj të gjithë që islamit mos t'ia veshin shpifjet e tyre të fabrikuara dhe tendencioze dhe myslimanët mos t'i etiketojnë me ato që nuk iu takojnë duke ofruar mundësinë për revanshizëm, mëri dhe hasmëri, por ta kuptojnë se i vetmi ilaç për tejkalim të tyre është vetëm toleranca, nëse e kuptojmë mirë Arnold Volltrei-n.

Literaturë e shfrytëzuar:
Ternava Naim, *Bazat e besimit-AKAIDI 1*,Prishtinë 1998.
Ljevakovic Doc.dr.Enes *Tema bashkohore të Fikhut (Përkthime interne dhe te pabotuara ne gj.shqipe),Sarajevë 2006*
Fjalori anglisht i Oxfordit "*The Oxford English Dictionary*", pa vit botomi.

Ensar HALIMI 12/a

KISHIM, KEMI DHE DO TË KEMI NEVOJË PËR TY

Një nga pyetjet që ia bëj shpeshherë vetës, është se sa patëm nevojë për Ty, o Resulullah, për momentin me mijëra përgjigje më vinë në kokë.

Çdo ditë dëgjoj njerëzit duke thënë: Kam nevojë për këtë, kam nevojë për atë e shumë gjëra të tjera. Por, pa marrë parasysh se sa je nevojtar për diçka, ajo diçka një ditë mund të bëhet e parëndësishme për ty. Vallë, a mund ta imagjinojmë sa kemi nevojë për udhëzimin e Krijuesit tonë Fuqiplotë, gjë të cilën nuk do ta arrijmë pa ndihmën Tënde o Resulullah?!

Të flasësh për jetën Tënde, është gjë e dhimbshme, sepse Ti, Muhamed kishe një fëmijëri të rëndë. Ti nuk pate fatin ta njohësh babain, por as me nënën nuk qëndrove gjatë. Për Ty u kujdes gjyshi e pastaj xhaxhai Yt. Megjithatë, Ti kishe dashurinë dhe kujdesin e Krijuesit të të gjitha krijesave, i Cili kurrë nuk të braktisi.

Edhe pse u rrite në një rreth me plot injorancë, Ti u dallove për virtyte të larta, sa që ofiqi Yt ishe "El-Emin", sepse ti ishe besnik, i dashur, i sjellshëm, nuk tradhtoje, thjesht në zemrën tënde nuk kishte vend për dashakeqësi.

Ti u linde në një vend të bekuar me plot vlera, po në atë kohë ato vlera ishin tretur diku. Në atë kohë ku qielli ishte mbuluar nga errësira e injorancës, atëherë kur toka ishte ngulfatur nga mëkatet e njerëzve kur e keqja ishte ngulitur thellë në zemrat dhe mendjet e tyre. Po si nuk iu deshe Ti njerëzimit o më i dashuri i Allahut?!

Ti na mësove se jeta në këtë botë nuk është i tërë rrëfimi, por vetëm një pjesë e tij. Fillimi i rrëfimit ka ndodhur qysh para lindjes sonë dhe do të vazhdojë edhe pas vdekjes. Pra, na tregove se jemi në një udhëtim, i cili në çdo moment mund të përfundojë dhe të dalim para A!!ahut duke bartur barrën e veprave tona.

Me ardhjen tënde në këtë botë, dalëngadalë zemrave iu hoq ndryshku shumëvjeçar duke iu kthyer shkëlqimi i margaritarëve të besimit, pra si nuk patëm nevojë për këshillat Tua o Resulullah?! Ashtu siç të përshkruan Allahu xh.sh në Kur'an:"Ti je në shkallën më të lartë të moralit". Ti ishe dhe do jesh shembulli më i mirë i një robi të devotshëm e falënderues. Ne kishim, kemi dhe do të kemi nevojë të marrim shembull jetën Tënde dhe personalitetin Tënd.

Hyrishahe MORINA 12/v

MADHËSHTIA E PIRAMIDAVE DHE MENDJELEHTËSIA E FARAONËVE



Allahu xh.sh. thotë:
"Thuaj: "Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm! Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në Amshim. Ai as nuk lind, as nuk është i lindur. Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë!" **(El Ihlas).**

Nga ajeti i lartpërmendur kuptojmë se nuk ekziston Zot tjetër përveç Allahut xh.sh. por ka disa njerëz që nuk e pranojnë këtë të vërtetë nga mendjemadhësia dhe injoranca e tyre.

Rast konkret kemi faraonët. Thuhet se faraonët i ndërtuan piramidat për shkaqe fetare, sepse besonin se nëse trupat e tyre do të vendoseshin në piramida të tilla ato nuk do të prisheshin. Por, nga Kurani famëlartë kuptojmë motiv tjetër të ndërtimit të piramidave, e që ishte mendjemadhësia. Mendjemadhësia e tyre arriti deri në atë shkallë saqë ta përshkruajnë veten e tyre si zot duke pretenduar se nuk ekziston asnjë zot tjetër përpos tyre. Këtë e shohim qartë në deklarimin e njërit nga faraonët, i cili kërkoi nga ministri i tij t'ia ndërtojë një kullë të lartë e ta shoh Zotin e Musait a.s. nëse Ai ekziston! Këtë kërkesë e bëri para parisë, nga e cila druante se ndoshta po i besojnë Musait a.s., e në këtë mënyrë sikur iu sillte dëshmi se vetëm ai është zot, e tjetër përpos tij nuk ekziston. Allahu xh.sh. thotë: ***"E faraoni tha: O ju pari, unë nuk njoh zot tjetër për ju pos meje andaj ti o Haman mi pjek (tullat) nga dheu e më ndërto një kull të lart ndoshta do të arrijë ta shoh Zotin e Musait sepse unë mendoj se vërtetë ai (Musai) është gënjeshtar". (Al-Kasas: 38).***

Mirëpo, sikur faraoni të ishte zot, vallë a do të kishte kërkuar ndihmë nga ndihmësi i tij?! Për fat të keq ai e konsideronte edhe parinë përreth për njerëz mendjelehtë. Sikur të ishte zot a do të kishte nevojë për ndërtimin e atyre piramidave?! Por, shtrohet pyetja se kush i ndërtoi këto piramida, dhe a janë faraonët autorë të këtyre ndërtimeve gjigante?! Pa që madhështia e ndërtimit të piramidave sikur i tejkalon kapacitetet njerëzore, sepse mënyra e ndërtimit të tyre nuk është zbuluar ende. Arsyeja e kësaj është se ndërtimi i tyre është shumë i ndërlikuar sa që mendohet se një njeri i thjeshtë nuk mund t'i ndërtojë ato.

Mendimi më kryesorë është se ky ndërtim gjigant është nga dijetarët e lashtë egjiptian dhe me ndihmën e një fuqie punëtore, e cila mendohet të ketë arritur rreth 2 milion.

Ndërsa mendimi tjetër është se ato i ndërtuan jashtëtokësorët, përkatësisht UFO-të. Gjithashtu ekziston mendi-

mi se ato i ndërtuan populli i kontinentit të supozuar që ekzistonte, dhe i cili u zhduk, e që quhej Atlantis. Vend i cili gjatë përmbytjes shumë njerëz arritën të shpëtonin dhe u larguan drejt Egjiptit. Mirëpo, siç shihet mendimi më i arsyeshëm dhe më i përafërt është mendim në të cilin thuhet se ato i ndërtuan populli Ad.

Kush ishte ky popull?

Sipas ajeteve kur'anore mendohet se këta ishin pasuesit e Nuhut a.s. pra populli Ad. Popull i cili që nga pamja e parë ishin shumë të mëdhenjë gjithashtu edhe fuqinë e kishin të madhe. Allahu xh.sh. thotë:

"Përkujtoni kur Ai ju bëri mëkëmbës pas popullit të Nuhut dhe u shtoi fuqinë fizike". **(A'raf 69).**

Gjithashtu Allahu xh.sh. thotë:

"Dhe sillni në mend, kur Ai ju bëri zëvendës pas fisit Ad dhe ju dhuroi vendbanime në Tokë; në rrafshinat e saj po ngrini pallate e në kodrina po gdhendni shtëpi. Kujtoni të mirat e Allahut dhe mos bëni çrregullime në tokë!" **(El Ea'raf: 74).**

Pra, ky popull sipas rrëfimit kur'anor ishin popull trupmëdhenjë dhe gjigant, meqë ndërtonin shtëpi të ndryshme brenda shkëmbinjve në kodra të mëdha. Thuhet se madhësia e trupit të tyre ishte në përputhshmëri me madhësinë e gurëve me të cilët janë ndërtuar piramidat. Pra ndërtimi i piramidave mund t'u përkiste popullit Ad.

Megjithatë ky popull devijoi, duke u treguar mendjemëdhenj ndaj besimit në Zot. Allahu xh.sh. thotë: ***"Sa i përket Adit ata pa pasur kurrfarë të drejte u treguan mendjemëdhenj ndaj banorëve në tokë dhe thanë: Kush ka fuqi më të madhe se ne? A nuk e ditën ata se Allahu i cili krijoi ka fuqi më të madhe se ata ?! Por ata i mohuan argumentet tona".*** (Fussilet: 15).

Kështu Allahu xh.sh. i dënoi ata dhe pas dënimit i përshkruan në kur'an në këtë formë ***"... si të ishin trupa hurmash të shkulura".*** (Kasas: 20).

Nga ajeti kuptojmë se ata ishin aq trupmëdhenjë saqë dukeshin sikur të jenë trupa hurmash të shkulura. Dënimi i Zotit ndaj tyre ishte edhe për të mbetur argument për të tjerët (mësim për të tjerët që të mos veprojnë si ai populi).***"... ashtu që nuk shihej gjë tjetër përveç banesave të tyre".*** (Ahkaf: 25).***"... e vendbanimet e tyre janë të qarta për ju".*** (Ankebut: 36).

Pavarësisht tërë kësaj, faraonët erdhën dhe banuan në banesat e tyre pa analizuar fare se kush ishte Ajo madhëri që shkatërroi popullin Ad. Kjo tregon injorancën e tyre. Pra, ata u vendosën dhe morën autorësinë e piramidave. Vallë, përse nëse i ndërtuan vetë piramidat, pse nuk i ndërtuan edhe shtëpitë e tyre në atë mënyrë?! Por vetëm piramidat (që ata i përdorën si varre).

Përse menduan vetëm për trupin e tyre pas vdekjes?

Por siç shihet ata nuk i ndërtuan vetë, por ato i gjetën të gatshme dhe frika e madhe që e kishin prej vdekjes i shtyu ata që ato piramida t'i shfrytëzonin për varreza dhe jo si shtëpi gjersa ishin gjallë. Më interesantja është se faraonët vetvetiu tregonin se nuk i ndërtuan ata vetë piramidat. Kjo argumentohet edhe nga një tekst i gdhendur mbi statujën e një zoti të tyre të quajtur "majmun" ku shkruhet: *"Forca e krahut të njërit prej ndërtuesve të piramidave është sa e njëmijë burrave".*

Secili nga faraonët mundohej të tregohej më i madh se paraardhësi i tij, sepse mundohej të fshinte shenjat e tjetrit për t'u treguar se ai ishte sunduesi dhe ndërtuesi i piramidave.

Të vërtetën e plotë e di vetëm Allahu Një.

O Zot na largo nga mendjemadhësia dhe na bëj të mësojmë nga pësimi i tyre!

Jusra ABDULAHU 11/v



NDJEHEM E HUAJ

Shikoj përreth por asgjë nuk shoh.
Thonë se këtë e kam atdhe por unë s'e njoh.
Jetoj në këtë botë e për të s'ndjej asgjë.
Kam çdo gjë e s'posedoj asgjë.
As trupin që me të bëj çdo gjë
As edhe qelizën më të vogël në këtë univers gjigant
Ndihem udhëtare.
Ndihem e huaj kudo që shkoj.
S'i përkas këtij vendi, e di.
E ndjej në çdo dhimbje dhe lumturi.
Është dikush që sundon.
Është dikush që posedon.
Është diku një arsye pse në këtë botë figuroj.
Është diku një punë që duhet ta përfundoj.
E kam diku një shtëpi ku do e ndjej një ngrohtësi.
E kam diku një lumturi që do e kem në përjetësi.
E kam diku një rehati që s'e gjej në gjithësi.
Kam frikë të jetoj në këtë botë.
Kam frikë se asgjë s'është stabile.
Kam frikë të fle se ndoshta më nuk zgjohem.
Kam frikë të udhëtoj se ndoshta më nuk kthehem.
Kam frikë të notoj se ndoshta fundosem.
Vdekjen e kam aq afër sa s'e shikoj dot nga afërsia.
E kam aq pran sa s'e ndjej dot nga prania.
Jeton me mua e s'arrij t'a vërejë.
Ngado që shkoj vdekja më pret.
Çfarëdo që bëj një shpërblim do e ketë.
Çfarëdo që shikoj një mrekulli më paraqet.

Merjeme KQIKU 11/v

NË ZEMRAT TONA

Jetojmë të lumtur pa kufi
A thua do të zgjasë kjo gjithnjë
Festojmë, festojmë pa ia nda
Një për të gjithë e të gjithë për një
Bashkë çdo kund na takon
Ftohtit e as të nxehtit s'na ndalon
Bardhësi jeta për ne kalon
Të lumtur do të jetojmë përgjithmonë

Jeton Raçi 13

Asaj...

Toka jote e shenjtë
E ujitur me gjak
Këmbën e barbarit
S'e duron aspak

Çdo ditë për ty flijohen
Burra, gra e fëmijë
Me gjëmën tënde kërkon
Çlirim e jo skllavëri

Dëshiroj të ndihmoj
Së paku me lutje
Se pa të parë njëherë pa pranga
S'mund të vazhdoj tutje

Lus Allahun, të Vetmin Udhëzues
Të na mëshirojë me mëshirën e Tij
Që të shoh njëherë PALESTINËN
Të frymojë në liri.

Jeton JASHARI 13

MUHAMEDI A.S

Ti vuajte pa masë që në vegjëli
Jetën e kishe të vështirë edhe në rini
Zoti xh.sh dritën ta dha ty
Që me nurin tënd gjithë botën me përfshi

Ata që dritën tënde e pësuan
Këshillat e tua i dëgjuan
Me nder e drejtësi jetuan
Të mirat nga Zoti xh.sh i fituan

Je shembulli më i mirë i njerëzimit
Këshillove t'i largohemi mashtrimit
Drejtësinë gjithmonë si duhet ta ndajmë
Selamin, paqen nëpër botë ta shpërndajmë

Ardiana LLUGIQI 11/v

GARAT
në kuizin e diturisë

Aktivitetet që nxisin për punë e angazhim nuk munguan as këtë vit në Medresenë e Mesme "Ala-uddin".

Pas përgatitjeve e lodhjeve të frytshme, erdhi koha që garueset nga Prishtina e Prizreni të dalin ballë për ballë e të garojnë në kuizin e diturisë të mbajtur në mars të këtij viti në lokalet e shkollës sonë në Prishtinë.

Më saktë, më 4 mars 2011 pas arritjes së paraleles së ndarë fizike në Prizren, filloi gara në konkurrencën e vajzave. Hapja e garave u bë si zakonisht me ajete kur'anore nga nxënësja e klasës së 13-të Adelina Tahiri.

Kjo garë ishte e ndarë në dy pjesë. Në pjesën e parë në garë hynë klasat e dhjeta dhe të njëmbëdhjeta (Prishtinë dhe Prizren). Komisioni nuk kishte aspak punë të lehtë për shkak të përgatitjeve të shkëlqyeshme të nxënëseve. Këtë e argumenton fakti që kjo përballje shkoi deri tek rundi i katërt kur përfundimisht u vendos që vendi i parë t'i takoj klasës së **njëmbëdhjetë**-Prishtinë me garueset: Besa Kqiku, Ermira Mehani, Imrane Sylejmani. Vendin e dytë e zuri klasa e njëmbëdhjetë –paralelja në Prizren, ndërkaq vendi i tretë i takoj klasës së dhjetë -Prishtinë me garueset: Jehonë Sylejmani, Vildane Gashi, Fatlinda Klinaku.

Pas kësaj gare të fortë e interesante filloi pjesa e dytë, por tani me rregulla më strikte me qëllim të eliminimit sa më të shpejtë të ndonjërës palë. Përsëri gara nuk ishte e lehtë dhe pas një garimi të fortë u caktua vendi i parë dhe i dytë. Mirëpo konkurrenca vazhdoi edhe më tutje për vendin e tretë. Dhe pas shumë bisedimeve komisioni më në fund vendosi t'i bëjë të njohura fitueset. Vendin e parë e zuri klasa e trembëdhjetë - Prishtinë në krye me: Adelina Tahiri, Bardha Kqiku dhe Mersime Krasniqi. Vendin e dytë klasa e dymbëdhjetë - paralelja në Prizren, ndërkaq vendin e tretë e zuri klasa e dymbëdhjetë - Prishtinë me garueset: Fatime Morina, Hyrishahe Morina dhe Vlora Sopjani.

Me këtë rast u dhanë edhe mirënjohje për fitueset e garave duke i shpërblyer me një shumë simbolike të hollash. Gara përfundoi me një drekë të përgatitur nga drejtoria e shkollës.

Pas tre ditësh, me 7 mars vazhdoi kjo garë edhe për djemt nga Prishtina, Gjilani dhe Prizreni. Gara kishe po të njëjtin intezitet me garën paraprake. Duke përfunduar me këtë rezultat:

Niveli i I:
Vendi i parë klasa 11 - Gjilan, me garuesit: Mërgim Alidema, Arlind Salihu, Adem Sakihaj
Vendi i dytë klasa 11 - Prizren, me nxënësit: Bekir Bytyqi, Dardan Suka, Mevlan Krasniqi
Vendi i tretë klasa 11/b Prishtinë, me garuaesit: Enis Arifaj, Behxhet Kodraliu, Korab Haxha.

Niveli i II:

Vendi i parë klasa 12/a - Prishtinë me përfaqësuesit: Besar Miftari, Ensar Halimi, Valdet Gashi
Vendi i dytë klasa 12 - Prizren me nxënësit: Dardan Gashi, Masar Skenderi, Sallem Rama
Vendi i tretë klasa 13 - Prishtinë me nxënësit: Ajet Aliu, Gëzim Ilazi, Afrim Arifi.

Adelina TAHIRI 13/v

NXËNËSIT DHE NXËNËSET më të dalluara në shkollë

Nxënëset më të dalluara për vitin shkollor 2010/11 Prishtinë

Nga e djathta:
Adelina Tahiri -13v,
Hyrishahe Morina -12,
Bardha Kqiku (ulur)- nxënësja më e dalluar në shkollë,
Imrane Sylejmani -11,
Jehonë Sylejmani -10.

Nxënësit më të dalluar për vitin shkollor 2010/11 Prishtinë

Nga e djathta:
Qëndrim Cakaj -10/b,
Bedri Zeka -10/a,
Qendrim Krasniqi -12b,
Enis Arifaj -11/b,
Besar Miftari -12/a.

Nga e djathta (ulur):
Ardian Dermolli -13,
Gëzim Ilazi - nxënësi më i dalluar në shkollë dhe
Bashkim Jashari -11/a.

Një natë pa gjumë

Ishte koha e gjumit dhe unë isha duke fjetur në dhomën time. Më vinin ëndrra dhe ankthe të tmerrshme që unë pothuajse isha i zhytur në djersë nga ato mundime dhe më në fund më doli gjumi. Isha i frikësuar dhe i brengosur nga ato ëndrra,që nuk e dija se çfarë mesazhi më jepnin. Dola në dritare dhe shikoja hënën diku larg që mezi dukej. Fillova të mendoj për krijimin e gjithë asaj që syri im shikonte edhe pse ishte errësirë. Flisja me veten time dhe thosha: A thua çfarë do të bëhet me mua pas vdekjes sime?! Pyetje të shumta që nuk mundja dot t'u gjeja përgjigje. Mendoja që do të përfundonte gjithçka, por jo! Papritmas mu kujtuan shumë ajete kur'anore dhe hadithe të Pejgamberit a.s që flasin për botën e ardhshme dhe që sadopak ma kthjelluan mendjen time.

U ngrita të marr abdest për të falë namazin e sabahut. U lidha në namaz dhe u qetësova plotësisht. Përfundova namazin, bëra lutje drejtuar All-llahut që të më mbrojë dhe të më largoj nga çdo e keqe që mund të më shpie në humbje.

Dhe dalëngadalë pashë se zbardhi dita, e cila më dukej se më thoshte: "O njeri,ngrihu nga aty dhe më shfrytëzo, sepse unë do iki dhe më nuk do të më takosh deri ne ditën e Kiametit, kur unë do të dëshmoj për ty."

Burhan KUKAJ 12/b

Mëngjes dimri

Qëndroja e heshtur pran dritares dhe shikoja me habi fëmijët teksa loznin. Mendja menjëherë më shkoi aty ku zemra dëshiron të jetë. Aty ku dielli lind dhe perëndon ndryshe, aty ku edhe bora më jep ngrohtësi. Ku jetër, pos në vendlindje!? Syri më lotoi e zemra qau kur e mendoj largësinë.

Kilometrat më ndajnë nga familja e shoqëria. Dimrin e kaluar nuk e përjetova kështu e vetme. Dimri i kaluar për mua ishte stinë e ngrohtësive përderisa bashkë me familjen shikoja fjollat e borës që binin lehtë mbi fytyrat tona.

Tani kam persona krejt tjerë para vetes, para meje qëndrojnë njerëz të huaj, të cilët as që më njohin.

Sa do të doja të kaloja bukur me këta njerëz të huaj, qoftë edhe vetëm një ditë dimri. Por jo, sot po me shoqëron vetëm një kujtim i bukur nga një dimër në vatrën familjare.

Eliza BUBLAKAU 10/v

Meditimi

Natë e qetë! Era frynte lehtë e më ngacmonte nganjëherë.
Vetëm këngët e gjinkallave më largonin nga të menduarit.
Yjet me shkëlqimin e tyre zbukuronin qiellin e hëna me rrezet e saja më shndriste fytyrën.
Eh, sa bukur dukej hëna me yjet që e rrethonin ashtu si nëna me bijat e saja.
Shikoja në lartësi, ndërsa isha ulur në tokë,në atë ku Krijuesi im më krijoi nga dheu i saj.
Sa i çuditshëm është krijimi ynë nga pak ujë e baltë.
Kur shikova përsëri lartë,hëna filloi të hyjë ngadalë pas reve të errëta në qiellit e artë.
Papritmas filloi të bie shi. Në fytyrën time,mendova se ishte shi,por jo, ishin lotët e mi.
Lot, që binin pa ndalur, duke meditуar në Krijuesin e vetëm të gjithësisë.

Mersime KRASNIQI 13/v

DELEGACIONI I KUVAJTIT

Delegacioni Kuvajtian në përbërje të të cilit kishte deputet dhe zyrtar të lartë shtetërorë në krye me Waleed Al-Tabtabae-deputet dhe kryetar i Komunitetit Ekzekutiv të Grupit të Miqësisë Parlamentare të Kuvajtit vizituan Medresenë e mesme Alauddin në Prishtinë.

Në shoqërim të këtij delegacioni ishte edhe myftiu i Republikës Mr.Naim Tërnava. Ata u pritën nga drejtori Bahri Simnica, i cili njoftoi delegacionin rreth shkollës, të arriturat, sukseset dhe sfidat me të cilat përballet institucioni. Më pastaj delegacioni i bëri një vizitë objektit shkollor dhe falën namazin e xhumasë. Pas përfundimit të namazit nxënësve iu drejtua me një fjalim rasti Muhamed El-Mutteri, duke uruar nxënësit për suksese dhe falënderuar stafin e shkollës për punën që është duke bërë. Ai theksoi nevojën e vazhdimit të mbarëvajtjes së mësimit dhe ngritjës së cilësisë edhe më tej në të ardhmen.

Ai përfundoi duke lutur Allahun për suksese dhe duke shpresuar në takime të tjera në të ardhmën.

Në fund për delegacionin dhe mysafirët e tjerë u shtrua drekë në restorantin e Medresesë.

Jennifer Washeleski viziton Medresenë

Ndër vizitat e shumta që ka Medreseja, ishte edhe ajo e Jennifer Washeleski nga Ambasada e SHBA-ve në Kosovë.

Me këtë rast u organizua një takim me nxënësit e shkollës ku hapjen e takimit e bëri drejtori i shkollës Bahri ef. Simnica me një fjalë rasti. Pas tij fjalën e mori Jennifer Washeleski ku u diskutua edhe lidhur me sistemet e shkollimit në SHBA, me ç'rast u krijua një atmosferë mjaft interesante.

Pas këtij tubimi vizitorët patën rast t'i vizitojnë pjesët tjera të shkollës si: kabinetin kompjuterik, bibliotekën, xhaminë, si dhe kabinetin e gjuhëve ku me këtë rast nxënësët e klasës së trembëdhjetë bënë një prezantim me sllajde lidhur me dëmin që shkakton alkooli dhe duhani.

"Ishte një prezantim i bukur dhe shumë mbreslënës" - u shprehën vizitorët në fund të takimit.

Adelina TAHIRI 13/v



Ekran i lakueshëm AMOLED nga Samsung

Gjatë dy viteve të ardhshme Samsung ka për qëllim të filloj me prodhimin e versioneve më të qëndrueshme te ekraneve plastike AMOLED për celularë.

Ekranet e reja do të kanë mundësi të mbështjelljes dhe rezistencë më të theksuar nga goditjeve dhe dëmtimeve fizike, duke ruajtur të gjitha përparësitë e kësaj teknologjie.

Supozohet se Samsung planifikon ta arrijë këtë gjë me instalimin e TFT-së drejtpërdrejt në filmin plastik dhe me zëvendësimin e mbrojtjes së deritanishme nga vinili me një version tjetër me poliamide.

Kompania parasheh një kërkesë më të madhe të ekraneve më të holla dhe të lehta AMOLED, e këto versione më të qëndrueshme do të fillojnë prodhimin masiv nga viti 2011.



Tyche - planeti i ri i sistemit tonë Diellor





Shkencëtarët janë afër vërtetimit të ekzistencës së një planeti të ri në sistemin tonë Diellor, të quajtur Tyche. Tyche llogaritet të jetë katër herë më i madh se Jupiteri, i cili momentalisht konsiderohet si planeti më i madh i sistemit tonë Diellor.

Astrofizikanët Johne Matese dhe Daniel Whitmire të Universitetit Lafayette të Luizianës janë ata të cilët po flasin për herë të parë për ekzistencën e këtij planeti. Ata besojnë se planeti i ri "fshihet" në renë Oort, e cila krijon mbështjelljen e jashtme të sistemit Diellor, shkruan The Independent.

Tyche, është një planet gjigant i përbërë nga gazra, kryesisht hidrogjen dhe helium, i cili mund të ketë një mase prej 5.300 herë më të madhe se Toka.

Besohet se planeti i ri është katër herë më i madh se Jupiteri dhe orbita e tij është afërsisht 375 herë më e madhe se e Plutonit, transmeton Ikub.

Sipas portalit Gizmodo, Tyche ka një temperaturë prej -73 gradë C/-99.4 gradë F, krahasuar me asteroidet rreth tij, të cilët kanë një temperaturë afër zeros absolute.

Prova e ekzistencës se planetit të ri është marrë nga NASA nëpërmjet teleskopit hapësinor Wise, por informatat nuk janë analizuar ende në tërësi.

Profesori Matese deklaroi për The Independent se Bashkimi Astronomik Ndërkombëtar (IAU) do të vendosë nëse planeti i ri do të bëjë pjesë në sistemin tonë Diellor

RËNDËSIA E FORMAVE RELIEVORE
NË JETËN E NJERIU

Relievi ka rëndësi të madhe në jetën e njeriut, ato forma të cilat njeriu i ka studiuar dhe i studion ende dhe është munduar tua gjejë rëndësin dhe mirësinë, Zoti i madhërishem e ka treguar atë në Kur'anin e Madhërishëm para 14 shekujve. Në një ajet Kur'anor thuhet: *"Ne kemi krijuar male të patundura në tokë, me qëllim që ajo të mos lëkundet dhe tronditet bashkë me ta..."* (El Enbija 31)

E shumë e shumë ajete të tjera që flasin për gjithësinë, tokën e mrekullitë e tyre. Dëshira e Allahut nuk qe vetëm mëkëmbja e njeriut në tokë por ia mundësoi atij (njeriut) një jetë më të mirë falë këtyre formave që në dukje të parë nuk janë të rëndësishme.

Pastaj e la të lirë njeriun në zgjedhjen e jetesës së tij. Që nga atëherë e deri më tani relievi i ka ndihmuar njeriut shumë, i'a ka mundësuar blegtorinë, bujqësinë, vendbanime të volitshme e shumë të mira të tjera.

Shpeshherë malet janë bërë pengesë që vendbanimet e njerëzve të bëheshin pluhur nga erërat e stuhitë e forta e nga shumë faktorë klimatik.

Ajeti Kur'anor thotë:*"Kur i sheh malet mendon se ato janë të palëvizshme, ndërsa ato lëvizin si retë..."* (En-Neml 88).

Vullkanet në dukje të parë janë shkatërruese dhe të dëmshme mirëpo në çdo gjë gjendet e mira sado e keqe ajo gjë qoftë. Hiri i vullkaneve mundëson një tokë produktive ku mund të kultivohen lloje të ndryshme të pemëve dhe perimeve dhe llojeve të ngjashme. Lartësitë mbidetare dhe lartësitë malore ndikojnë në zhvillimin e turizmit mirëpo përveç kësaj përmirësojnë gjënë më të shtrenjtë, shëndetin e tij. Shumë lugina rrafshina e ultësira mundësojnë zhvillimin e kulturave të ndryshme bujqësore të domosdoshme për jetën. Ka shumë forma të tjera që kanë rëndësi dhe dobi të madhe për njeriun .

Prandaj njeriut nuk i mbetet tjetër veç ta falënderoj Krijuesin e tij që ka bërë që jeta e njeriut të jetë shumë e rëndësishme sa që të gjitha gjërat në tokë janë në dispozicion të njeriut që ai ti shfrytëzoj në mënyrën më të mirë.

Besa KQIKU 11 /v

Krenaria e myslimanes

Një pasdite kur dielli lëshoi rrezet pingul, që binin mbi qerpikët e saj vezullues, përbënin fije të gjata qerpiku të kristalta.

Në sytë e saj që vezullonin si ylli i parë i mbrëmjes, vërehej dëshira për të arritur aty ku harronte të gjitha brengat e kësaj bote, e në fytyrën e saj të bukur, vërehej një buzëqeshje që i jepte pamje mbretërore…Ajo lëvizte me hapa të ngadalshëm e të sigurt…

Mbi krahërorin e saj të drejtë e kishte lëshuar shaminë ngjyrë trëndafili, që flladi i lehtë pranveror lehtas ia barte herë në një anë e herë në anën tjetër. Bënte lëvizje të matura, e herë-herë ndonjë gjest të ëmbël që e bënte të dukej engjëllore.

Nga anë të ndryshme goditej me shikime tinëzare nga të dy gjinitë, disa e shikonin me lakmi e disa me zili. Herë-herë dikush lëshonte nga një fjalë, por asaj nuk i bënte përshtypje asgjë, përsëri vazhdonte të lëvizte me të njëjtin ritëm.

Derisa arriti në vendin ku ajo çdo ditë me plot zemër merrte rrugën, aty ku freskohej shpirtërisht, mbushte zemrën me dashuri e mëshirë nga përkujtimi i Atij që e kishte shpëtuar nga fundosja dhe e kishte ngritur aq lart. Zemra e saj tanimë i gufonte nga gëzimi, që shprehej në fytyrën e saj plot nur…

Islami ishte ai që e bëri të shndrit margaritarin e nxjerr nga fundi i oqeanit plot errësirë…

Adelina TAHIRI 13/v

Droga dukuri shkatërruese

Të them është shkatërruar bota, janë shkatërruar njerëzit nuk mundem. Ngase duke u mbështetur në një thënie të Dërguarit kjo akuzë ngrihet mbi mua.

I Dërguari a.s. në një rast kishte thënë :" Kush thotë se është shkatërruar njerëzimi, dijeni se ai person është shkatërruar ".

Por të them se është duke shkuar në rrugë të gabuar, besoj se kam të drejtë. Përderisa shumë të rinjë kalojnë kohën në shtëpi, në shkollë, duke lexuar libra, apo thjeshtë duke e shfrytëzuar kohën, ndërsa pjesa tjetër e rinisë, gjenden në qoshen e errët te ndonjë rrugice të vetmuar, duke shkatërruar me dorën e vet vetveten, familjen, shoqërinë. Kur futesh në botën e errët të drogës nuk sheh asgjë pos saj, e vështirë dilet nga ajo. Mënyra se si futet njeriu në atë "botë" nëse kam të drejtë ta quaj të atillë, është e ndryshme.

Ndodh që edhe nga kureshtja hyjnë në errësirën e drogës, në errësirën që në pluhurin e saj vdekjeprurëse kaplon mendjen dhe zemrën. Errësira zë vend në gjoksin e një të riu, në vend që në atë gjoks të jehoj shpresa për një të ardhme të ndritur, dashuria për jetën. Dihet se kur njeriu humb Udhërrëfyesin qiellor, ai humb fuqinë e mendjes për të shkuar drejt rrugës së drejtë. Pra, le t'i kthehemi Krijuesit sepse shpirti arrin lumturinë e vërtetë kur arrin të njoh pronarin e Tij.

Albulena HAJRAJ 12/v

Buzëqesh

Falënderimi i takon vetëm Allahut xh.sh, Krijuesit të çdo gjëje dhe të Gjithëdijshmit, ndërsa përshëndetjet ia dërgojmë Pejgamberit tonë Muhamedit a.s.. Lus Zotin që të gjithë ata që e adhuruan Allahun dhe që e adhurojnë të bashkohemi në Xhenetin Firdeus!

Fjalë, fjalë dhe përsëri fjalë…

Na është bërë një shprehi dhe një zakon shumë i keq që të flasim pakufi dhe pa e kontrolluar të folurit tonë.

A jemi ne të vetëdijshëm që aparati i të folurit është shumë me rëndësi për jetën e njeriut, me këtë aparat njeriu mund ta bëjë jetën e tij të lumtur, por mund edhe ta bëjë të hidhur. Sa e sa njerëz janë të hidhëruar, e sa të tjerë janë në ngatërresa, e sa kanë vdekur e janë shkatërruar. Për shkak të gjuhës! Po, a thua që edhe familjet ndahen dhe jeta e tyre bëhet ferr, thjesht vetëm për një arsye, fjalët e tyre pa vlerë, fjala e tyre boshe dhe me synim të keq...?!

Sa te këqija që mund të sjell kjo gjuhë e jonë e pakontrolluar, e cila nuk kërkon energji të madhe, për të ofenduar dhe për të shkatërruar shoqërinë e formuar me vite të tëra. Po a mendojmë që ne me anë të gjuhës e hidhërojmë edhe Krijuesin tonë, Allahun xh.sh. dhe për këtë do të ndëshkohemi në botën tjetër.

Allahu thotë: *"Vërtet, ata që përgojojnë gratë e ndershme, zemërdëlira e besimtare, janë të mallkuar në këtë botë dhe në tjetrën. Për ta ka dënim të madh ditën që do të dëshmojnë kundër tyre gjuhët, duart dhe këmbët e tyre për çfarë kanë bërë"* (En-Nur 23-24).

Ne e dëgjojmë fjalën e të Plotfuqishmit dhe përsëri të njëjtën me fjalë të pamatura, me tallje dhe me ofendime te panumërta. Po me vije turp të flas dhe të tregoj, po ne jemi aq të pamëshirshëm saqë edhe ndaj prindërve që na rritën me vështirësi dhe mundime të shumta, nuk jemi të kujdesur që të paktën në mëngjes t'u japim një buzëqeshje.

Pejgamberi a.s. ka thënë: *"A t'ju tregoj për gjynahun më të madh?" Ne i thamë: "Gjithsesi, o i Dërguar i Allahut". Tha: "Shirku dhe sjellja e keqe me prindërit". Pasi ishte shtrirë, u ul dhe tha: "Ta dini se gjithashtu edhe rrena", dhe vazhdoi ta përsëriste këtë, derisa thamë: "Sikur të ndalej!"*

(Tr. Buhariu dhe Muslimi nga Ebi Bekrete (r.a).

Ndërsa Umeri (r.a.) thotë: *"Kujt i shpeshtohen fjalët, i shpeshtohen lëshimet. Kujt i shpeshtohen lëshimet, i shpeshtohen gjynahet. Kujt i shpeshtohen gjynahet, Zjarri është që më së shumti i shkon përshtati".*

Pra, kjo është e ardhmja jonë që ne po ndërtojmë. Pse nuk e kultivojmë buzëqeshjen në fytyrën tonë?! Më thuaj çfarë mund të zgjidhim me britmë dhe me zë të ngritur?! Pse jemi të prirë për të keqën?!

Tani mu kujtua edhe një veti e jonë jo e rrallë, të gënjejmë në shkollë, ta gënjejmë mësuesin tonë, i cili me shumë dashuri vjen në orë dhe na ligjëron, na edukon, që të kemi një të ardhme më të ndritur.

Buzëqesh para se të bëhet vonë, buzëqesh para se të qash, buzëqesh sot që të buzëqeshësh edhe nesër.

Thotë Hasen el- Basriu: *"Sa e çuditshme është çështja e birit të Ademit! Dy ruajtës i ka te koka e tij. Gjuha e tij është lapsi i tyre. Pështyma e tij është ngjyra me të cilën shkruajnë. Ndërsa mes gjithë kësaj flet për çështje që nuk i hyjnë në punë".*

Mos thuaj se pa folur nuk ka gjë se një fjalë poetike thotë: *"A nuk e sheh se luanit ia kanë frikën, edhe pse është i heshtur, ndërsa qenit s'i frikësohen, edhe pse leh?".*

Driton FETA 13

Fjala e fundit e maturanteve

Adelina Tahiri: *Nëse në një kopsht nuk mbjell lule,në atë kopsht do të mbinë ferrat.*

Adile Krasniqi: *Humbja e kohës është më e keqe se vdekja,me vdekje humbim këtë jetë,ndërsa me humbjen e kohës,humbim Ahiretin.*

Arbnore Dili: *I can accept failure,everyone fails at something. But I can't accept not trying.*

Arta Avdiu: *I spend most of my life worrying about that things that never happened*

Bardha Kqiku: *Nëse furtuna udhëheq kahjen e erërave, atëherë fatkeqësia udhëheq zemrën që luhatet.*

Behare Llalloshi: *Dynjaja është ura e Ahiretit,kaloje atë dhe mos ndërto mbi të, nuk është punë e mençur të ndërtosh kështjellë mbi urë*

Belkize Avdiu: *Nuk kam kohë të merrem me ata që më urrejnë,sepse jam e zënë duke i dashur ata që më duan.*

Fadile Bajoku: *Vjen një moment në jetë kur kupton kush ka rëndësi, Kush s'ka pasur kurrë, kush s'do të ketë më dhe do të ketë përgjithmonë. Mos u mërzit për njerëzit që i përkasin të kaluarës tënde, ekziston një arsye pse ata nuk janë pjesë e së ardhmes tënde.*

Flova Mavriqi: *Nëse dëshiron të jesh e lumtur në këtë jetë, rrëmbeja dashurinë të tjerëve me sinqeritet.*

Ganimete Jusufi: *Çdo kush mendon për veten e tij, ndërsa shpirtmiri mendon edhe për të tjerët.*

Hikmete Zymberi: *Fjala e mirë është sikurse margaritari që del nga guaska,e fjala e keqe është sikur tmerri i errësirës që del nga humnera.*

Krenare Berisha: *It's all the same in the end...!!*

Liridonë Tahiri: *Mik i vërtetë është ai që dallon pikëllimin në sytë e tu,përderisa të tjerët besojnë në buzëqeshjen tënde.*

Luljeta Bytyqi: *Nëse nuk e di se ku po shkon, çdo rrugë do të shpie atje.*

Marigonë Gashi: *Time will tell us whether we have friends or only their names.*

Magbule Aliu: *Njeriu mund të pendohet nga fjalët e tij, mirëpo asnjëherë nga heshtja e tij.*

Mersime Krasniqi: *Jeto jetën tënde me atë që e ke dhe gjithmonë do të jesh i lumtur.*

Merita Boroci: *Vepro të mirën, largohu nga e keqja dhe urdhëro të veprojnë edhe të tjerët kështu.*

Merva Hajdari: *Më mirë një fund i dhimbshëm,se një dhimbje pa fund.*

Mevlude Gajtani: *Mjaftë njerëz të rëndësishëm më kanë humbur në jetë...o Zot mos mi largo edhe ata pak që më kanë mbetur.*

Rejhane Krasniqi: *Ta arrish kënaqësinë e qiellit...duhet të mësosh hapat se si ecet në tokë.*

Sadie Mavriqi: *Mos mendo se je në rrugën e duhur,vetëm se është mjaftë e shkelur nga të tjerët.*

Suada Havolli: *Dynjaja është si deti, ahireti është bregu, anija është devotshmëria, ndërsa njerëzit janë udhëtarët.*

Shkurta Musliu: *Kënaqu me disa pjesë të errëta të jetës sate,sepse drita është aty,e tëra që duhet të bësh është ta ndezësh atë dhe ta shikosh duke ndriçuar.*

Shpresa Jusufi: *Shpresë do të thotë jetë, ashtu edhe ti qofsh gjithmonë për dikë.*

Trëndelina Qupi: *Nëse të thonë se vlen zero, mos u mërzit kujto që zeroja është para të gjithëve.*

Valmire Krasniqi: *Fjala e mirë është pasaportë për arritje te çdo zemër.*

Vlora Avdiu: *Preferoj urrejtjen e sinqertë nga armiku, sesa ngrohtësinë e rreme nga miku.*

Fjala e fundit e maturantëve

Afrim Arifi: العلم لا يعطيك بعضه إلا إذا أعطيته كلك و إذا أعطيته بعضك لم يعطيك شيئا

Ajet Aliu: *"Dituria është sikur llamba, kush kalon para saj do të ndriçohet".*

Ardian Demolli: *"Kush e rregullon brendësinë e tij, Allahu do t'ia rregullon të jashtmen e tij. Kush e rregullon atë që duhet mes tij dhe Allahut, Allahu do t'ia rregullon atë që duhet mes tij dhe të tjerëve".*

Ardit Gashi: *"Shoqëria është si ajri, e nevojshme për frymëmarrjen, por e pamjaftueshme për jetën".*

Astrit Berisha: *"Çdo njeri është dikush, por mendjemadhi s'është askush".*

Bashkim Berisha: *"Evito "pse-n" para se të thuash "pse"!*

Bedri Rama: *"Miqtë e mirë janë si duart dhe sytë, kur dora lëndohet, syri qanë, kur syri qanë dora fshinë lotët".*

Behar Gashi: *"Synova fitoren, fitova përvojën, përvoja më mësoi rrugën, rruga më është bërë e qartë".*

Berat Shehu: *"I'am alive again, more alive than I have been in my whole entire life".*

Bexhet Bajrushi: *"Fjala që buron nga zemra hyn në zemër".*

Burhan Jakupi: *"Dhe vjen një ditë... kur e tashmja bëhet dikur".*

Burim Krasniqi: *"Ajo që di është sa një pikë uji, ajo që nuk di është sa një oqean".*

Driton Feta: *"Qeshu dhe bëj shaka sa të duash por mos gënje".*

Durim Abazi: *"Të mirët janë të tjerë, të tjerët janë si unë, e unë nuk jam si ata ngase jam vetvetja".*

Egzon Gërguri: *"Kam ëndërruar që jeta të jetë e lumtur. Kur jam zgjuar kam kuptuar se jeta është e vështirë. Kam punuar dhe jam bindur se te vështirësia qëndron lumturia".*

Fatbardh Rrahmani: *"Nata është e gjatë, mos e shkatërro atë me gjumin tënd, dita është e shenjtë, mos e turbullo atë me mëkatet tua".*

Fidaim Havolli: *"Të gjendesh ku të gjendesh mos harro të përkujtuarit e Allahut xh.sh".*

Gëzim Ilazi: *"Kur njeriut i piqet mendja, i pakësohet fjala".*

Gëzim Syla: *"Përkujtimi i Zotit për zemrën është si uji për peshkun".*

Halim Selimi: *"Mos mallko terrin, por ndeze dritën".*

Ilir Tahiri: *"In the way of life can walk good, just them who know where are going to!"*

Jeton Jashari: *"Nuk është e rëndësishme të dish se sa shokë ke, por me rëndësi është të dish se për sa njerëz je një shok i mirë".*

Jeton Raçi: *"Fjala është si bleta që ka edhe mjaltin edhe thumbin".*

Korab Ismaili: *"When you desire something greatly you have to fight in order to Win".*

Liridon Shkodra: *"Buzëqeshja është fjalë e bukur pa shkronja".*

Orlis Hasani: *"Mos ndiq vetëm rrugë të shtruara, por shko në një rrugë të pa shkelur dhe le gjurmë".*

Ptariot Haliti: *"Herë me hiri e herë pahiri, shpeshherë gabon edhe i miri".*

Qendrim Ferizi: *"Patience With others is Love, Patience with self is Hope, Patience with God is Faith."*

Skender Murati: *"Jeta është urë, mos ndërto shtëpi mbi të".*

Valon Berisha: *"Tri gjëra nuk kthehen prapa: fjala e thënë, besa e dhënë, dhe shigjeta e hedhur"*

Valon Potera: *"Po të mos ishte "pse" nuk do të ekzistonte arsyeja".*

Zejnullah Zeqiri: *"Mendjet e forta janë ato të cilat bota e zhurmshme i dëgjon të fundit".*



"Si mund t'ju them lamtumirë"

Nuk dua të futem mes jush dhe t'ju pengoj, vetëm dua t'ju tregoj sa shumë ju vlerësoj. Nuk dua të di çfarë sekreti ke ti, vetëm dua të të them se për mua ke rëndësi.

Ju kam lënduar pa dashje, këtë e di, por dijeni se atë e kam bërë paqëllim me siguri. Gjithmonë kam menduar se jeni ju ato që më keni forcuar. Jeni ju ato qe hidhërimin në gëzim ma keni shndërruar, jeni ju ato që më keni bërë të qaj nga gëzimi,më keni bërë të qesh nga hidhërimi,më keni kërkuar shërbim e atë e kam bërë pa përtim, më keni besuar ndonjë gjë e atë nuk e kam kthyer me tradhti.

Kemi luajtur derisa jemi lënduar, kemi qeshur derisa jemi rrëzuar, kemi qarë derisa jemi gëzuar dhe gjithmonë kemi vazhduar mësimin derisa e kemi përfunduar.

Kam mësuar me ju gjithçka!

Kam mësuar të dua e edhe të urrej, kam mësuar t'i kuptoj njerëzit e edhe t'u ndihmoj, kam mësuar ta marr problemin e edhe ta shqyrtoj, kam mësuar se shoqëria është ajo që më së shumti kam pasur nevojë.

Kam mësuar se ndarja nuk është vetëm ndarje, por edhe takim, se vetmia nuk është veç vetmi, por edhe shoqërim se fundi nuk është vetëm fund por edhe fillim.

Kam mësuar se edhe nëse ndahemi nuk do të largohemi, edhe nëse ikim prapë do të takohemi edhe nëse vdesim prapë do të bashkohemi.

Asnjëherë nuk kam menduar se do të vij fundi,do të vij ndarja nga ju,nga gjithçka. Do të largohemi për tu parë pas shumë vitesh, kur ne nuk do të jemi ato të bankave shkollore, kur gjithçka të ketë ndryshuar, kur Unë dhe Ti do të përqafohemi të mallëngjyera për kohën të cilën të ndara e kemi kaluar.

Atë ditë kur në derën e shkollës përsëri të takohemi, do të qajë dhe do të kujtoj ditën kur u ndamë, do të kujtoj lotët në sytë e tu, dhimbjen që kemi kaluar, kohën që çdoherë e kërkuam, shoqërinë që kurrë nuk e harruam.

Do të kujtoj zërin tënd kur më thërriste nga larg për të më treguar se je afër e për t'u përqafuar.

Do të kujtoj dorën tënde tek fshinte lotin tim që pikonte vetëm për ty, lojërat që bënim pa menduar se më nuk jemi fëmijë. Do të kujtoj gjithçka, çdo cep, çdo bankë, çdo gjë, çdo buzëqeshje, qoftë ajo edhe fshehtas nga të tjerët. Do të kujtoj kur më the: "Me gjithë shpirt do ta mbaj gjallë kujtimin për ty."

Do të kujtoj çdo takim, çdo test që shtyhej pambarim, çdo shpjegim që nuk e kuptonim me qëllim.

Do t'ju kujtoj juve shoqëria ime që jeni pjesa më e bukur që Zoti më ka përcaktuar për ta jetuar.

Do të kujtoj ty si një mike besnike.

E në fund do të kuptoj se tek të pash ma kujtove jetën shkollore,do ta freskoj kujtimin për ty kur të të shoh përsëri në bankat shkollore, do të kthehem në kohë e do të tregoj se të kam menduar me mendje e të kam përmendur me gojë.

Prandaj mos harro se do të kalojnë kohë e do të ndryshojnë stinët do të ndryshojmë ne, por jo edhe kujtimet. Dhe kujto se sot e për mot kur të ulemi dhe të mendojmë, do të kujtojmë ndarjen dhe takimin, gëzimin dhe hidhërimin, do të kujtojmë gjithçka...

Besa KQIKU 11/v

Do ndjejë mall për Ju

Kohë më parë kam lexuar një thënie, që aq shumë aludonte në ju. Thuajse të ishte shkruar pikërisht për ju. Aty thuhej "Rëndësia e njeriut nuk matet me vendin që zë, por me boshllëkun që krijon kur ai largohet". Besoj që kjo mjafton për ta shprehur atë që ju simbolizoni për ne.

Kur mendoj se një ditë do të hyjë në klasën tuaj, do të shoh fytyra të reja. Sa e vështirë për syrin e lëre më për zemrën. Do ju kërkoj mes turmës se shkollës por s'do ju gjej, ju tanimë kishit ikur. Do ju kërkoj në klasë, në korridor e në çdo qoshe të shkollës. Do të dal edhe në oborr për t'ju kërkuar, se mos vallë keni dalë të argëtoheni ashtu siç dikur dinit të bënit më së miri. Por jo, do të më duhet ta pranoj se juve nuk do ju gjej më në skutat e kësaj shkolle ku sa shumë gjëra përjetuam. Përjetuat gëzime e hidhërime.

Ishte pikërisht ky vendi ku njohët shoqërinë e vërtetë. Ti që sot je maturante kujto se ky ishte vendi ku arrite të gjesh shoqen e cila kupton mërzinë në sytë e tu, përderisa të tjerët i besonin buzëqeshjes tënde. Arrite ta njohësh shoqen e cila këndonte këngën pikërisht atëherë kur ti harroje fjalët. Arrite ta njohësh vetveten në trupin e dikujt tjetër. Por gjithashtu arrite ta kuptosh se çfarë është jeta reale. E pas gjithë kësaj besoje se nuk është lehtë të thuash lamtumirë. T'i përshëndesësh ditët më të bukura të jetës, se kush e di a do t'i gjesh më. T'i thuash lamtumirë orëve të mësimit që aq shumë qeshnit pikërisht atëherë kur duhet të ndaleshit. T'i thuash lamtumirë lojërave me shoqen tënde, kur e qeshura ngrihej deri në qiell. E tani t'i braktisësh të gjitha këto, vetëm jeta me ligjet e saj të urdhëron kështu, e që s'është aspak e lehtë.

Besoni që do t'iu marr malli edhe për tabelën plotë formula e detyra që aq shumë i urrenit. Do ju marr malli edhe për bankat që nganjëherë i goditnit nga kënga e nganjëherë edhe nga mërzia. Do ju marr malli që të ngriheni edhe një herë në këmbë për të dhënë një përgjigje edhe pse ndoshta e gabuar, edhe pse ndoshta të tjerët do të qeshnin me ty.

Do ju marr malli edhe për testet që aspak nuk i pëlqenit. Një ditë teksa do të jeni duke ngrënë bukë në një vend tjetër,do ju marr malli që të prisni edhe një herë me rend, edhe pse dikur aspak nuk e donit. Por të gjitha këto me mbrëmjen e maturës do të mbyllen në librin e kujtimeve, për ti ruajtur ato me egoizëm.

Sa shumë kanë ndryshuar gjërat. Dikur ju përcillnit dikë, por sot rolet kanë ndryshuar, kësaj radhe ne do ju përcjellim juve, kurse vitin tjetër do jemi ne ato që do të largohemi nga këtu. Do të largohemi kështu me radhë për tu lënë vend gjeneratave të reja, që edhe ato t'i përjetojnë ato që ne i përjetuam.

Sa egoiste është jeta. Pikërisht kur rehatohesh, atëherë është koha të bëhesh gati për të vazhduar rrugëtimin e jetës. Por mbajeni në mend, ecën mirë vetëm ai që din ku shkon. Pra, oj maturante vëri qëllim jetës tënde, që të mos bëhesh e harruar në pluhurin e kohës. Ka ardhur koha që të zgjohesh, ngase ata që flenë nuk i dinë fshehtësitë e natës.

Por, prapë se prapë kudo që të të dërgoj jeta me valët e saja, mos e harro vendin ku mësove se kjo jetë është gjithçka, por edhe asgjë. Ku mësove se ndarja nuk është vetëm fund por edhe fillim, ku mësove se të ekzistosh do të thotë të ndjesh gëzimin, por edhe dhimbjen.

Njeriu nuk mund të ndahet nga hija e vet ashtu siç nuk mund të ndahet nga fati i tij.

Pra ky është fati juaj. Çdo ditë që po kalon po e afron ditën e ndarjes. E dini çdo të thotë kjo? Po afrohet dita kur do të jemi të detyruara që me gjuhën e fjalëve t'u themi lamtumirë, por assesi edhe me gjuhën e zemrës. Sepse për zemrat që duhen me dashurinë e sinqertë ndarja është vetëm largim fizik e asgjë më shumë.

Albulena HAJRAJ 12/v

Po të lë Medrese

Ditët vetëm se janë duke u numëruar, orët mësimore në ditarin shkollor po plotësohen nga pena e atyre që na shoqëruan për katër vite.

Misioni ynë këtu në bankat shkollore po përfundon. Atje jashtë na pret një botë e tërë e gatshme të na tregoj historinë e saj shekullore. Nevoja e saj për ndihmën tonë është e madhe, andaj edhe u edukuam e u formuan që të ndihmojmë.

Çdo moment e çast të jetës sime këtu e përjetova si gjënë më të bukur e që dhimbja që po të lë, po më shoqëron pas. Vitet e shkuara në ngrohtësinë tënde më ofruan njohje për më shumë, i dhanë kuptim fjalëve që shkruhen në ditarin tim.

Dashuria e madhe që të japësh dije edhe ata që kaluan në pragun e derës sate i frymëzoi nga njerëz me dije të cekët u formuan individ me një opus të gjerë.

Ai që deshi të marr nga ti, mori pothuajse gjithçka që i duhej. Njohuria që ofron për kuptimin e krijimit të vetës e universit nuk ka fund.

Çfarëdo që mundohem të them ndoshta nuk mjafton ta përshkruaj atë që me të vërtetë meriton të thuhet për ty. Në brendinë e mureve tua u gdhendën emra që mbetën të pashlyer nga kalimi i kohës.

Faleminderit Medrese që më fale miqësinë, ma mësove bujarinë, më ndeze dritën e të menduarit, më drejtove drejtë qëllimit të vërtetë.

Po të lë medrese, për t'i lënë radhë të tjerëve që të përfitojnë nga ti ashtu siç bënë shumë të tjerë si puna ime. Lamtumirë!

Bardha KÇIKU

Nëna



Nënë, nënë, nënë e them me aq kënaqësi këtë emër.

Emër për të cilin kam dashuri të madhe dhe të sinqertë, saqë as lapsi s'mund ta përshkruajë. Nëna, qenia më e dashur dhe më e privilegjuar në tërë rruzullin tokësor, aty ku arrin dita dhe nata. Privilegje me anë të së cilave të pushton zemrën dhe të mundëson të gjesh prehje, qetësi, paqe e shumë dashuri.

Në zemrën e saj ka aq shumë dashuri që do të mjaftonte për të gjithë njerëzit.

Qëndrim CAKAJ 10/b

Jetimët

O Zot i lartësuar
Të gjithë të kërkojmë ndjesë
Lumturoja më shumë jetën
Jetimëve të pashpresë

Me du'a dhe lutje
Mundohem të qetësohem
Të lutem o Zot në Xhennet
Të pranohen!

Jetimët e shkretë
Qëndrojnë gjithmonë me lot në sy
Shpresën e fundit Allah e kanë tek Ti

Do të vjen dita
Kur ata do të gëzohen
Çasti më i hareshëm
Kur në Xhennet me prindërit
E tyre do të takohen.

Flora MAVRIQI 13/v

ISH NXËNËSJA E MEDRESESË KORRË SUKSES NË NIVEL NDËRKOMBËTAR

Garat kombëtare të shkathtësive juridike **"2011 Philip C. Jessup International Law Moot Court Competition"** u mbajtën me 28-30 Janar, 2011, në Universiti Teknologjik MARA, në qytetin Shah Alam të Malajzisë.

Morën pjesë gjithsej 45 student prej 9 universiteteve publike dhe private të Malajzisë.

Ekipi i përbërë prej 5 studentëve (prej të cilëve edhe ish-nxënësja e medresesë, **Nora Huseinovic** nga Universiteti Ndërkombëtarë Islamik triumfoi në këtë garë, duke fituar të drejtën e përfaqësimit të shtetit të Malajzisë në gara ndërkombëtare që do mbahen me 20-26 Mars, 2011 në Washington D.C.

Këto janë garat më prestigjoze dhe më të mëdha të shkathtesive juridike në botë, ku marrin pjesë studentët prej më shumë se 80 shteteve të botës. Garat janë stimulim i një mosmarveshjeje fiksionale ndërmjet dy shteteve, ku studentët duhet të mbrojnë klientin (shtet) të tyre para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Këto gara mbahen çdo vit në Washington D.C. që nga viti 1959.

Problemet të cilat trajtohen në garat Jessup të këtij viti kanë të bëjnë me të drejtën ndërkombëtare humanitare, të drejtën ndërkombëtare të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe të drejtën ndërkombëtare kundër korrupsionit. Studentët që përfaqësojnë shtetet e tyre në Washington kanë shansin të prezantojnë para gjykatësve të vërtetë pranë Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, si Bruno Simma, Dame Rosalyn Higgins, Stephen M. Schwebel, dhe gjykatësve pranë Tribunalit të Hagës për ish-Jugoslavinë si Fausto Pocar, Patricia M. Wald, etj.

MEDRESEJA PËRFAQËSON KOSOVËN NË GARAT E KUR'ANIT NË IRAN



Më 18.11.2010 nxënësi Egzon Ibrahimi së bashku me Drejtorin e M.M "Alauddin" Bahri Siminica si dhe Koordinatorin e paralelës së ndarë në Gjilan dr.Fahrush Rexhepi dhe nxënësi Ruzhdi Sadiku kl.3 Gjilan udhëtuan për Teheran.

Qëndrimi i tyre atje zgjati një javë ku gjatë kësaj kohe përveq garave vizituan shkolla, universitete, xhami dhe vende historike të Iranit. Aty patën rastin që gjatë prezantimit të tyre në gara të takohen me shumë përfaqësues shtetesh nga mbarë bota ku ndër ta edhe ata të Shqipërisë.

Dita e dytë ishte koha kur ata do të përfaqësonin Kosovën si shteti më i ri në botë ku u prit me një respekt të veçantë ngase ishte hera e parë që Kosova merrte pjesë.

Egzoni si zakonisht përfaqësoi denjësisht në leximin e bukur të Kur'anit në një garë që konkurrenca ishte shumë e madhe dhe e fortë gjë që zëri i tij i bukur i bëri për vete të gjithë pjesmarrësit, jurinë dhe publikun.

Nxënësit tanë me këtë rast fituan mirënjohje dhe dhurata të ndryshme për pjesëmarrje.

Mervan SIMNICA 11/b (sipas rrëfimit të pjesëmarrësit Egzon Ibrahimi)

ORA E MEKKES



Udhëtimet janë shumë të rëndësishme në jetën e njeriut. Qysh nga kohët e lashta udhëtimet luanin një rol të rëndësishëm si*omos në historinë arabe. Imam Shafiu thotë: "Udhëto, sepse në udhëtim ka pesë dobi"*që d.m.th. udhëtimet sjellin dobi të shumta. Kur'ani fisnik na e përkujton se vërtetë arabët bënin udhëtime në verë dhe në dimër ku Allahu i Madhërishëm thotë në suren El-Kurejsh, ajeti 1-2: "(Shkatërrimin e njerëzve të elefantit Allahu e bëri) për të mbrojtur fisin Kurejsh, për të mbrojtur ata në udhëtimin që bëjnë dimër e verë." Pasi që udhëtimet e tyre në dimër ishin për në Jemen, kurse ato gjatë verës për në Sham (Siri).

Tani udhëtimet disa i quajnë "turizëm", siç është turizmi argëtues dhe sportiv, për tu zhytur në ujë etj, pastaj turizmi për qëllime kulturore. Më i rëndësishmi prej tyre është turizmi me karakter fetar, prandaj do të përkufizoj fjalën time, miku im për: Udhëtimin tim drejt Medinës së ndritshme dhe Mekkës së bekuar. Allahu deshi dhe më lehtësoi udhëtimin për ta kryer Umren në muajin e kaluar gjë që u kënaqa me vizitën që i bëra Medines së ndritshme dhe Xhamisë së të Dërguarit të Allahu xh.sh.. Ajo xhami të bën të ndihesh më i lumtur dhe i qetë. Ti vërtetë ndihesh në të si të ishe në shoqëri me të Dërguarin a.s., në të shijon aromën e Xhennetit. Pejgamberi thotë: *"Ndërmjet varrit tim dhe minberit tim është një kopsht prej kopshteve të Xhennetit..."*, prandaj të jesh në xhaminë e Pejgamberit a.s. të bën të ndjesh lumturi, pastërti dhe dëlirësi, të cilën pastërti nuk do ta ndjesh asnjëherë në vende të tjera, e më pastaj jam drejtuar drejt Haremit të Mekkes (Qabes). Nga larg prej një distance më tepër se 10 km. Pata rastin ta shoh një orë të lartë, një kryevepër arkitekture të lartë më se 402 m. Ajo mund të shihet prej të katër anëve dhe prej një largësie të madhe. Atje lartë mbi këtë orë nga katër anët qëndron "emri i Allahut" gjegjësisht shkronja hemze në emrin e Allahut ka gjatësinë më shumë se 23 metra në drejtimin kryesor, kurse

në pjesën e pasme në të dyja anët është e shkruar: *"Nuk ka Zot tjetër pos Allahut dhe se Muhammedi është i Dërguari i Tij "*.

Ora e Mekkes është më e madhe se sa Big Beni i famshëm për gjashtë herë dhe për fatin tim të mirë pasi që kreva Umren, pas tavafit rreth Qabes, pas vrapimit ndërmjet Safas dhe Merves dhe pas pirjes nga uji Zemzem shkova në hotelin e afërm me Qaben dhe shikoja pas perdeve, e shikoja orën shumë qartë, e shikoja atë të bukur shumë, e shihja atë të lartë dhe krenare.

Sipërfaqja e anës së përparme të saj ishte 42 mijë metra katror e punuar nga karboni fiber, i cili përdoret në industrinë e aeroplanëve bashkë-kohorë.

Ora është e stolisur me 98 milion copë mozaikë nga qelqi me ngjyrë të cilat ia shtojnë madhështinë dhe bukurinë. Do të mahnitesh kur do të mësosh se gjatësia e akrepave të minutave është më se 22 metra, ndërsa gjatësia e akrepave të orës është 17 m. Do të mahnitesh edhe më shumë kur të mësosh se çdo akrep i orës peshon më se 6 tonelata, ndërsa pesha e orës në tërësi është 36 mijë tonelata. Realizimi i tërë projektit të kësaj ore ka kushtuar tre miliardë dollarë.

Në manifestimet islame, siç është fillimi i muajve Hixhrijj si dhe në festat islame ndriçimi bëhet me 16 reflektor,drita e të cilëve arrin më larg se 10 km në drejtim të qiellit. Çdo reflektor ka 10 kw. Gjatë ezanit bëhet ndriçimi i majës së orës me 21 mijë llamba ndriçuese. Ora punon me anë të energjisë solare dhe sinjalizon kohën e hyrjes së namazeve, gjë që i mundëson edhe njerëzve me dëgjim të dobët si dhe atyre nga larg të dinë kohët e faljeve dhe fillimin e tyre.

Ora është projektuar me teknologjinë më të re në botë, energjinë solare, artin islam dhe gjenialitetin arkitektonik. Andaj, ora e meriton të hyjë në Librin e Ginisit

...Zoti e ruajt Islamin dhe myslimanët!

Dr. Sejjide Hamid
Nga revista *"El-Firdevs"*, Dhjetor 2010

Nga gjuha arabe:
Adelina TAHIRI, Bardha KQIKU, Vlora AVDIU, Mersime KRASNIQI, Krenare BERISHA dhe Valmire KRASNIQI 13/v

Shembuj nga Kur'ani Fisnik

Familja është mbledh në mbrëmje, gjersa Ahmedi tha: Sot e kam parë gjuhën arabe të flas për veten e saj me mburrje dhe krenari duke përshkruar bukurinë e saj me bindje të thellë.

Në emër të të gjithëve,tha nëna: E ka me të drejtë që të mburret me veten e saj, sepse Mëshirëploti e ka nderuar me Kur'anin Famëlartë.

Gjyshi: Pikërisht, ajo është gjuha e "Dadit" me fjalorin e saj të pasur, format (stilet) e saj të mrekullueshme dhe perlat (margaritarët) e saj të çmuara.

Ahmedi: Ajo na vë në garë neve në mes veti, për ne do të nxjerr secilën herë shkronja dhe tregime te ndryshme, dhe se ka informuar për testimin e parë për ne rreth fjalës "**es-sifru**", dhe lidhshmërinë e saj me Kur'anin Famëlartë, prandaj unë dëshiroj që të hulumtoj rreth fjalës "***es-sifru***", të lutem gjyshi im ku mund ta gjej atë?

Gjyshi: Es-sifru është me "sin"e jo me "sad" do të thotë *libri i madh*, sepse komentohet dhe qartësohet kuptimi kur lexohet, ndërsa Kur'ani Fisnik është libri i Shenjtë i myslimanëve, fjala e Zotit të botëve, të cilin e barti Shpirti besnik (Xhibrili a.s. deri tek Muhammedi a.s), i shkruar në mus-hafe, i ruajtur në gjokse, i lexueshëm (që mund të lexohet) me gjuhë, që mund të dëgjohet me veshë, në të na ka informuar Allahu xh.sh për çdo gjë, kështu që Kur'ani përmban dispozita, rite, shembuj, urtësi, kështilla, histori, si dhe njohuri mbi universin,dhe nuk ka lënë asgjë prej çështjeve të kësaj bote, e as sistemin e universit (gjithësisë) pa na sqaruar atë. Thotë Allahu i Lartësuar: ***"Ne ta zbritëm ty Librin, si shpjegim për çdo çështje ,si udhërrëfyes, si mëshirë dhe si lajm të mirë për muslimanët".*** (En-nahl,89)

Ai(Kur'ani) është mburojë për atë që kapet pas tij, dritë dhe shpëtim për atë që e pason.

Nëna: Mirëpo ku e mësuat ju këtë?

Ahmedi: Në gazetën e murit kam parë garën e gjuhës arabe, dhe dëshiroj që të shkruaj njohuritë e mija për shokët e mi që të kenë dobi...

Gjyshi: Qesh dhe thotë duke plotësuar fjalinë e tij: "dhe për shpërblim a nuk është kështu nipi im i dashur?

Ahmedi: Po.

Gjyshi: Atëherë do të flas për të, ndërsa ti shkruaj në stilin tënd atë që do ta kuptosh dhe do ta varësh në gazetën e murit. Thotë Allahu i Lartësuar: ***"Shembulli i atyre që janë obliguar me Tevrat e pastaj nuk e kanë zbatuar, i shëmbëllen gomarit që i bartë librat (por pa dobi)."*** (El-xhumua; 5)

Ky është një shembull të cilin e ka sjell Allahu xh. sh. dhe me të tregon për ata të cilët i ka nderuar me Tevrat dhe i ka obliguar me zbatimin e dispozitave të tij, kurse ata nuk vepruan me të, iu shmangën besimit në Muhamedin a.s. dhe hyrjes në fenë e tij, ndonëse në të (Tevrat) gjendej lajmërimi për ardhjen e Muhamedit.a.s.

Gjyshi: Çifutët të cilët jetonin në Medinë u thoshin dy fiseve Evs dhe Khazrexh se kjo



është koha e pejgamberit të përmendur në Tevrat, i cili thërret në njëshmëri dhe se ne do të jemi me të, mirëpo Evsi dhe Khazrexhi iu paraprinë çifutëve në besimin në Islam dhe në Muhamedin a.s., ndërsa kur Pejgamberi a.s migroi në Medinë çifutët nuk e besuan, e xhelozuan si dhe fshehën paralajmërimin për ardhjen e tij, i cili iu kishte zbritur në Tevrat, madje ata e ndryshuan edhe librin e tyre, e Allahu i krahasoi ata (duke qenë Tevrati ende në duar të tyre) me gomarin që bartë libra me vlerë ,të dobishme, e të çmuara, mirëpo nuk i kupton ato, nuk ka dobi prej tyre edhe pse i bartë duke mos përfituar asgjë përveç lodhjes dhe vështirësive, e në qoftë se do ta pyesësh çfarë je duke bartur, ose çfarë ka në këto libra? Nuk do të përgjigjej, sepse funksioni i tij në këtë jetë është bartja e barrëve të rënda dhe ngopja e barkut. Ndërsa fjala e Allahut: *"**e pastaj nuk e kanë zbatuar atë**"* do të thotë nuk ia kanë dhënë hakun dhe nuk e kanë zbatuar ashtu si duhej, d.m.th nuk kanë punuar me Tevrat dhe nuk kanë përfituar nga drita dhe nuri i Tij. Nuk e besuan Tevratin, e lexuan atë pa meditim dhe thëllim në të dhe as që punonin me të. Ky shembull është sjell për ata që nuk përfitojnë nga diçka që ju është dhënë, si dhe për dijetarin që nuk përfitohet prej diturisë së tij dhe njëherazi është tërheqje e vërejtjes nga Zoti xh.sh atij që bartë Librin (Kur'anin) që t'i mësoj fjalët e Tij dhe të punoj me Të.

Ahmedi: Atëherë gjyshi im, shembulli i sjellë nga Zoti xh.sh. sqaron që dituria e vërtetë nuk është vetëm njohuri, por edhe praktikimi i saj.

Gjyshi: Pikërisht ashtu djaloshi im. Ky shembull është sjellë edhe për atë që i kupton fjalët (porositë) e Kur'anit e nuk punon me të, sepse siç thuhet: *Dituria pa vepër është sikur pema pa fryt* dhe se për këtë shkak edhe Pejgamberi a.s kërkonte mbrojtje tek Allahu duke thënë: *"O Zot unë kërkoj mbrojtjen tënde nga ajo dituri (dije) që nuk përfitohet prej saj, dhe nga ajo zemër që nuk të frikësohet Ty, nga ai shpirt që nuk ka ngopje,dhe nga ajo lutje që Ti nuk e pranon."*

Nga revista *El-Firdevs*, Nëntor 2010
Nexhva Husjen Abdul Aziz
Nga gj. arabe: Afrim ARIFI, Durim ABAZI,
Ardian DEMOLLI dhe Ajet ALIU 13

Të parat edhe në volejboll

Të shtunën më 12.03.2011 në sallën sportive të Medresesë u mbajtën garat e volejbollit për vajza në nivel të shkollave të mesme. Ekipi i Medresesë u ndesh me ekipin e shkollës së mjekësisë "Ali Sokoli" ku patëm rast t'i shohim aftësitë sportive të të dyja shkollave.

Medreseja edhe në këtë rast vërtetoi se është ndër të parat në të gjitha aspektet, si në ato intelektuale ashtu edhe në ato sportive.

Përballja vazhdoi deri në pjesën e katërt. Pjesa e parë iu takoi nxënëseve të "Ali Sokolit", ndërsa nxënëset e Medresesë fituan në tri pjesët tjera.

Në fitoren e shkollës sonë mbase do të ketë ndikuar edhe përkrahja e shikueseve që shfaqën një tifo të zjarrtë përgjatë tërë ndeshjes për volejbollistet tona.

Adelina TAHIRI 13/v

Liga e shkollës

Sektori i sportit në kuadër të shoqatës së nxënësve të shkollës sonë, organizoi ligën e shkollës . Kjo ishe diçka e re por mjaft tërheqëse, interesante dhe mbresëlënëse për të gjithë.

Liga u zhvillua përgjatë 7 javëve dhe morën pjesë gjithsej 8 ekipe nga të gjitha klasat.

Ishte një garë e nxehtë dhe mjaft argëtuese për nxënësit ku në fund triumfoi klasa e 12 /a e cila mori vendin e parë kurse vendin e dytë dhe të tretë i morën klasa e 12/b dhe 11/a

Vlen të përmendet edhe golashënuesi më i mirë i ligës, Valon Potera kl.13.

Ardit GASHI 13

EDHE NJË BOTIM I RI I LIBRIT



Nxënësja Bardha Kqiku nxorri librin e parë autorial të titulluar "Kthehu" që e botoi Medreseja e mesme "Alauddin". Libri i lartpërmenduar ngërthen në vete problemet dhe sfidat e gjeneratës së re, ku me lehtësi kjo nxënëse ka arritur të kapë gjithë brengën e kohës në të cilën po jetojmë.

Me një fjalor të mrekullueshëm, me një qasje të lehtë dhe të kuptueshme ka trajtuar shumë çështje fetare, të cilat i shprehi si përmes poezisë, prozës e eseve ka arritur që të bartë mesazhe dhe këshilla tek gjeneratat e reja pa i harruar në këtë mes edhe gjitha moshat tjera duke dëshmuar kështu se për të gjithë ka vend në këtë fe dhe se të gjithë jemi pjesë e lëshimeve dhe gabimeve, andaj çdo kthim te Zoti xh.sh. nuk është i vonshëm dhe i papërmisueshëm.

Disa këshilla nga Hasan el Basriu...

1. Mos prit kohë dhe ditë të qëlluar për mësim! Dije se çdo orë dhe çdo ditë është e qëlluar për mësim.
2. Një kohë të caktuar bëje vetëm një punë, vetëm një mësim, respektivisht puno rreth një problemi derisa mos të dobësohen kujdesi dhe fuqia!
3. Pa e kryer një mësim që ke filluar, mos kalo në tjetrin!
4. Lëshimi pe, gjatë një problemi është përtaci e maskuar. Dashuria ndaj punës lindet dhe forcohet përmes përballimit të problemeve.
5. Ngadhënjimi në luftë dhe suksesi në mësim janë me atë që nuk kthehet prapa.
6. Nëse lodhesh me një punë, atëherë ndërroje atë ose ngadalësoje ritmin, por mos pusho!
7. Mendo mirë, pasi që puna nuk do të thotë vetëm të lëvizësh, të lexosh ose të shkruash. Njeriu që mendon, punon më tepër se xehetari në minierë.
8. Asnjëherë mos e vlerëso produktivitetin e mësimit me orë, por shihe rezultatin e asaj që ke mësuar.
9. Çdo ditë lexo nga dhjetë faqe të një vepre të mirë- ashtu që të zhvillohet aftësia e të folurit!
10. Mësoi përmendësh pjesët e bukura që i lexon, që të të pasurohet fjalori dhe shprehjet tuaja dhe përforcohet mbamendja!
11. Pas përfundimit të mësimit, përsëriti ato në kujtesën tënde dhe merr shënime!
12. Pjesët që i ke mësuar diskutoi me shokët.
13. Vlera e individit është e fshehur nën gjuhën dhe majën e lapsit të tij. Ajo shfaqet nëpërmjet fjalës dhe shkrimit.

Afrim ARIFI 13



Mos harroni!

Durimi është i hidhur por sjell fruta të ëmbël.

I verbëri është ai që i mungon drita e mendjes, jo drita e syve.

Për njeriun e mençur çdo ditë lind jeta e re

Te njeriu i mençur gjuha është pas zemrës,ndërsa te i padituri zemra është pas gjuhës.

Aty ku të gjithë mendojnë njësoj, asnjë nuk mendon shumë.

Miqtë mund të vijnë e të ikin por armiqtë grumbullohen gjithnjë e më shumë.

Një popull që fle, vdes.

Një herë pash që qanin një fëmijë i bardh dhe i zi, por lotët e tyre nuk kishin ngjyrë.

Fjalët e bukura janë si pikat e mjaltit që pikojnë, këto i japin shije shpirtit të njeriut.

Ngjyra më e bukur për sy është ulja e shikimit, e kjo është kozmetika më e mirë për sy.

E sa i përket pudrës në faqe, ngjyra më e mirë është morali.

Për buzë kozmetika më e mirë është ta flasësh të vërtetën.

Sapuni më i mirë është ai i pendimit.

Sa i përket bukurisë së flokëve është mbulesa.

Zbukurimi me stoli e me gurë të çmuar është pastërtia.

Kurse veshja më e bukur është devotshmëria.

Eliza BUBLAKU 10/V

Aktivitetet e nxënësve të Medresesë jashtë shkollës

Një ndër aktivitetet e shumta të nxënësve të shkollës sonë është edhe diskutimi i organizuar nga nxënësit e shkollës sonë dhe atyre të Shkollës së Mesme Teknike "28 Nëntori". Diskutimi u mbajt më 01.03.2011 në objektin e shkollës "28 Nëntori" me temë "Trafikimi i qenieve njerëzore".

Tema u ligjërua nga Merita Boroci, nxënëse e Medresesë dhe Kaltrina Selimi, nxënëse e "28 Nëntori", që të dyja dhanë mjaft fakte për dëmet që sjell "Trafikimi i qenieve njerëzore" në shoqëri, ato treguan edhe mënyrën se si mund ta parandalojmë këtë veti të shëmtuar.

Diskutimin e hapi drejtori i "28 Nëntori", pastaj fjalë përshendetëse mbajtën edhe drejtori i Medresesë z.Bahri Simnica, një përfaqësues i organizatë "PEN" si dhe përfaqësuesja e zyrës për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimës në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.

Falënderim të veçantë meritojnë drejtori i Medresesë që na përkrahu moralisht dhe materialisht si dhe drejtori i "28 nëntori" për mikpritjen dhe ndihmën që na ofroi.

Driton FETA 13

Pesëvjetori i themelimit të Departamentit të Gruas

Medreseja e mesme "Alauddin" përpos aktiviteteve brenda mureve të saj, ajo gjithmonë hap dyert për bashkpunim me institucione të tjera.

Departamenti i Gruas pran Bashkësisë Islame të Kosovës për hirë të pesëvjetorit të themelimit të saj, mbajti një program modest në objektin e medresesë "Alauddin" në Prishtinë.

Vullneti i nxënëseve për punë e aktivitet as këtë herë nuk mungoi. Ato morën pjesë në disa pika mjaft të rëndësishme të programit si: lexim të Kur'anit nga nxënësja Adelina Tahiri, pastaj udhëheqjen e programit e bëri Fadile Bajoku, dhe për ta freskuar programin nuk munguan as ilahitë e përgatitura nga nxënëset tona.

Për gratë të cilat vite me radhë kontribuan në çdo sferë të jetës u dhanë mirënjohje si shenjë nderimi e respekti për mundin e tyre.

Gjatë programit fjalën morën disa personalitete si: Besa Ismaili e Azemine Kukaj. Kjo e fundit mbajti një ligjeratë me të cilën pikë edhe e përfundoi programin.

Adelina TAHIRI 13/v

Ermira Mehani "Peisazh"



Kuriozitete

- Në Turqi gjendet një skulpturë, vepër e natyrës, që paraqitet një grua duke qarë. Lotët e saj rrjedhin me shekuj, por nga burimet e fshehta të ujit që ndodhen nën shkëmb.
- Kameleonët mund t'i lëvizin sytë në mënyrë të pavarur nga njëri tjetri. Njëri sy i tyre mund të shohë përpara dhe tjetri mund të shohë mbrapa në të njëjtën kohë.
- Peshqit ngjyrë floriri do t'a humbnin ngjyrën e tyre pa dritën e diellit. Ata kanë nevojë për praninë e dritës së diellit për të mbajtur pigmentin e tyre karakteristik.
- Elefantët janë gjitarët e vetëm që nuk mund të kërcejnë.
- Peshkaqeni i Bardhë mund të qëndrojë disa muaj pa ngrënë.
- Bletët kanë 5 sy, 3 të vegjël mbi kokë dhe 2 më të mëdhenjë në ballë.
- Dëgjimi i një delfini është kaq i mprehtë sa mund të dëgjojë një tingull mbi 20 km larg.
- Kërmijtë kanë 4 hundë: 2 për të marrë frymë dhe 2 për të nuhatur.
- Muhamedi a.s. ka marrë pjesë në 28 beteja.
- Allahu xh.sh në Bedër ka dërguar 1000 engjuj.

Hyrishahe MORINA 12/v,
Eliza BUBLAKU 10/v,
Merva HAJDARI 13/v

Barcoleta

Fakte mbi Chuck Norris

*Chuck Norris zogun e kamës e ka knus.
*Chuck Norris podrumin e ka n'kat dytë
*Chuck Norris kur don me pi qaj i thotë nanës dheze bojlerin!
*Kur lahet Chuck Norris edhe e harron dritarën e banjos qel jasht bohet mjegull.
*Chuck Norris i ka flokt e kuqe sepse lahet me llav t'vullkanit.
*Chuck Norris kur nxen peshqi thotë: ti-ti-ti n'kofe!
*Chuck Norris e shkrun n'google unë edhe ja qet foton e tij.
*Chuck Norris kur Bon skleka e shtyn tokën posht.
*Zorra qorre e Chuck Norris-it sheh.
*Chuck Norris ja ka pa ftyren asaj grus të Tom&Jerry.
*Chuck Norris kur han kikirika e din cili osht kiki e cili riki.
*Chuck Norris i mshel syt për me pa vetën n'pasqyre qysh doket kur flen.
*Krejt e udhëheqin vallën me mindil e Chuck Norris me tepih.
*Chuck Norris kur e dhez agregatin e shkel konopit edhe e ngre agregatin.
*Chuck Norris shtyhet me statuja kush pi mban syt qel ma gjatë.
*Chuck Norris e ka nxon oren 06:66.
*Chuck Norris i sheh andrrat HD edhe 3D

Enis ARIFAJ 11/B

Qëndrimi në Medrese për katër vite



Më kujtohen sekondat e parë të hyrjes sime në Medrese dhe që nga atëherë e deri në maturë kaluan 93312000 sekonda, po a thua harrohen 1555200 minuta që kaluan si era, po 259200 orë të bukura dhe të rehatshme a harrohen vallë...?! 1080 ditë si dallëndyshet e pranverës përgjatë 144 javëve do të mbeten në mendjen time, e të gjitha këto përmblidhen në 36 muaj që kaluan aq shpejt sa hap e mbyll sytë. (Këto ishin 4 vitet në Medrese pa i llogaritur vikendet dhe pushimet).

9331200 sekonda
1555200 minuta
259200 orë
1080 ditë
144 javë
36 muaj
4 vite

Gëzim SYLA 13

Kemi 365 ditë për të mësuar.

Nëse i heqim 52 të diela, na mbesin 313 ditë.

Gjat veresë, 50 ditë bonë motë mjaft i nxehtë, dhe kur i heqim edhe këto na mbesin 263 ditë.

Çdo natë flemë mesatarisht 8 orë, dhe kjo bënë 122 ditë në vit. Për mësim na mbesin 141 ditë.

Nëse në ditë për rregullim vetes ia kushtojmë vetëm 1 orë, në kohën tonë për mësim do t'na pakësohen edhe 15 ditë.

Na mbesin 126 ditë për mësim.

Nëse për ngrënje dhe pije harxhojmë 2 orë në ditë, na shkojnë edhe 30 ditë, e na mbesin 96 ditë.

Një nxënës i mirë kur del për të shetitur, nëse i harxhon vetëm 2 orë, tërë vitin kjo bënë 92 ditë, na mbesin vetëm edhe 4 ditë.

Tek e fundit ne jemi njerëz, e ndodh që të sëmuremi, apo jo? Nëse jemi të sëmur 3 ditë brenda vitit në fund na mbetet vetëm 1 ditë për mësim.

Dhe shikoni sa interesant: Rastis që kjo ditë të jet ditëlindja jonë!!!

viti	të diela	vera	gjumi	rregullimi	ushqimi	shetitja	sëmundje	ditëlindja	mësimi
365	-52	-50	-122	-15	-30	-92	-3	-1	= 0





F J A L Ë K R Y Q I

Autor: Mërgim Hasani	Lagjja e Medresesë së vjetër	Nëna e Pejgamberit tonë	Shkretëtira, ar.	Shkruaj E N	Linda Evans	Babai	Belgjika Monedhë e Japonisë		Gjenerata sh.	Ajër (huaj)	Shtetasja Indira	Gjermani	Emër mashkulli	Revista e nxënësve të Medresesë
Dëshmori Mustafë...								Kryeqyteti i Irakut						
Porosi (sh)								RIA Ekip				RR IU		
Shkruaj LI H				Futbollisti ZINEDIN	Dënim me internim A F									
Rrethi						Zanorja e parë	I Z H			Çift këng. Përemër vetor				
Ish drejtori i Medresesë në foto												Përemër vetor Një zanore		
A Zanore e jona		Një popull i lashtë Emri i ef. Nahi									Mendim Zot			
	Bashkting-llore Vegël muzikore		Babai i Jusufit a. s.							Një zanore		Shko Aktori SHARIF		
Shkronjë arabe										Shkruaj LI o			Uran Mëri	
Një pejgamber				Shkruaj E K U						Emër mashkulli				
Thembra këpuce										Emër femre				
Artistja EME										Fshat i Gjakovës	Bretkocë Emër femre			
Shkruaj R		B U Emër mashkulli ar								Shkruaj A Hajde		Titani Babai		
Një kontinent Zanorja e fundit				Partia Demokratike	Austria Reomir		Italia Përulje për tokë		Këngëtarja Ismaili A				Titaniti Intensiteti	
	Shkruaj A Njeri i parë		Ish targa e Prishtinës A N			Sulfur Emergjent ar.		Verseti Kryetar ar.						Emër mashkulli ar.
Një kaptinë (sure)					Jo brutal Një kaptinë				Një halif B K E				Amerika Nr. themelor	
Fe ar.				Një muaj hixhriji Pyetëse						A Shkruaj E J		Targa e Tiranës		
Erbiumi			E Arabisë S. Shkruaj M								Ije			
Muhamed		Shkolla e jonë										Shkruaj E F		

Trekëndëshi magjik

Plotësoni trekëndeëshin magjik duke vendosur shifra nga 1-7 në rrathët e zbrazët në mënyrë të tillë që shuma të jetë 12 në çdo drejtim.



Marigona GASHI 13/v

mashtrime optike

Sa vetura duken dhe sa janë në realitet...?!

Kjo pemë mbanë të fshehura 10 portrete... zbuloni!



rrathët vazhdojnë të lëvizin...

Është skelet apo vajzë në pasqyrë...?!

Përgatiti: Merjeme KQIKU 11/v

"Prandaj ruajuni All-llahut! All-llahu ju mëson ju..."

وَاتَّقُوا اللَّـهَ وَيُعَلِّمُكُمُ اللَّـهُ

Kherdet Rusinovci

Mr. Samir Ahmeti

Mr. Jakup Çunaku

Azemine Kukaj-Kajoshi

Fadil Hasani

Bahri Simnica
Drejtor

Naim Tërnava
Kryetar

Sylejman Osmani
Sekretar

Hatixhe Sadriu

Mr.Adnan Simnica

Muharrem Tërnava

Lejla Zhilivoda

Mr.Rrahim Aliu

Shahë Memishi
Kujdestare

M.M Alaud-din në Prishtinë

Maturantet 2011

Liridonë Jahiri

Hikmete Zymberi

Flora Mavriqi

Belkize Avdiu

Bardha Kqiku

Arbnore Dili

Adelina Jahiri

Adile Krasniqi

Artë Avdiu

Behare Llalloshi

Fadile Bajoku

Ganimete Jusufi

Krenare Berisha

Luljeta Bytyqi

Valmire Krasniqi

Suade Havolli

Shpresa Jusufi

Rejhane Krasniqi

Merva Hajdari

Merita Boroci

Magbule Aliu

Marigonë Gashi

Mersime Krasniqi

Mevlude Gajtani

Sadie Mavriqi

Shkurte Musliu

Trëndelina Çupi

Vlorë Avdiu

Gjenerata 10

Takimi 2021

Medreseja

Vatër e diturisë, dritë e ardhmërisë
Moral i njerëzisë, zhvillimi i shoqërisë.
O vend i pasur përplot me nur
Më dhe dituri më shumë se kurrë.
Tek ti mësova fshehtësi,
Ndër to të lartën Perëndi
Shumë gjenerata ti i shkollove
Në degë të ndryshme ti i aftësove
Shumë muderrisa e shumë doktorë
Fal emrit tënd me diplomë në dorë
Nami yt s'ka për t'u harruar
Do të mbetesh për herë fener i pashuar.
Na e mësove këtë fe na e mësove këtë din.
E pasur dhe me vlerë
Medreseja "Alauddin"

Elxhira BERISHA 11/v